

#jamisigurt
online

Përse një program për sigurinë e fëmijëve në internet?


Interneti tashmë është bërë element thelbësor i jetës sonë. Fëmijët përbëjnë 1 në 3 përdorues të internetit globalisht dhe më shumë se 175,000 fëmijë lundrojnë online për herë të parë çdo ditë (State of the World's Children 2017, UNICEF).

Aktiviteti fizik, leximi, ndërveprimi i zakonshëm njerëzor janë dhe do të mbeten komponentë kritikë për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, megjithatë, interneti sjell përfitime të konsiderueshme në nxënie, socializim, shprehje, përfshirje dhe pëmbushje të një sërë të drejtash.


Interneti i ekspozon fëmijët gjithashtu ndaj rreziqeve të reja, si qasja në përmbajtje të papërshtatshme, ndërveprime të dëmshme me fëmijët e tjerë ose me të rriturit, dhe ekspozimi ndaj praktikave agresive të marketingut.

Fëmijët mund të vënë në rrezik sistemet e tyre kompjuterike dhe të shpërndajnë të dhënat e tyre personale pa kuptuar pasojat afatgjata të privatësisë.

Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual i fëmijëve online është një trend shqetësues i dhunës ndaj fëmijëve dhe mbrojtja e tyre është bërë pjesë përbërëse e punës programatike të UNICEF-it në nivel global.



Format e dhunës dhe shfrytëzimit online



Në kuadër të forcimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri dhe shtyrë nga evidenca dhe të dhëna, puna e UNICEF është orientuar drejt një përgjigje gjithëpërfshirëse për dhunën ndaj fëmijëve online dhe synon të mbështesë Qeverinë Shqipëtare, shoqërinë civile, prindërit, kujdestarët dhe vetë fëmijët në zvogëlimin e rreziqeve dhe rritjen e përfitimeve pozitive të teknologjive moderne të komunikimit.

UNICEF dhe partnerët synojnë të arrijnë këto rezultate:

- 🎧 Të dhëna mbi rreziqet dhe mundësitë online informojnë programimin e ardhshëm.
- ✦ Fëmijët viktimë të abuzimit dhe shfrytëzimit online identifikohen dhe shpëtohen.
- ✦ Fëmijët viktimë të abuzimit dhe shfrytëzimit online marrin shërbime mbështetëse cilësore në përputhje me standartet dhe praktikën ndërkombëtare.
- ✦ Rastet e shfrytëzimit të fëmijëve online hetohen dhe ndiqen penalisht.
- 🎧 Materialet online të dhunës seksuale ndaj fëmijëve raportohen dhe hiqen/fshihen.
- ✦ Prindërit / kujdestarët, mësuesit dhe anëtarët e komunitetit marrin masa për të ulur rreziqet dhe parandaluar abuzimin dhe shfrytëzimin online.
- ✦ Fëmijët edukohen si të parandalojnë të mbrohen nga rreziku i shfrytëzimit dhe abuzimit seksual online.

Si do t'i adresojmë këto rreziqe?

Shtyllat kryesore të parashikuara në program për të adresuar rreziqet që rrjedhin për fëmijët nga mjedisi digjital:



Rritja e kapaciteteve

- 🕒 Mbështetje për rritjen e kapaciteteve për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve për të përmirësuar cilësinë e mekanizmave mbrojtës për fëmijët në rrezik dhe ata që kanë përjetuar abuzim në internet.
- ✦ Sigurimi i trajnimeve për autoritetet përgjegjëse shtetërore për të forcuar procesin e vendimmarrjes, për heqjen në kohë të materialeve me përmbajtje abuzimi seksual të fëmijëve në internet.
- ✦ Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të zbatimit të ligjit, si punonjësit e policisë, prokurorët dhe gjykatësit mbi legjislacionin, udhëzimet dhe protokollet e referimit, hetimin, ndjekjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimet në internet.
- ✦ Bashkëpunim i ngushtë me industrinë e TIK dhe Ofruesit e Shërbimeve të Internetit (ISP-të) për të rritur kapacitete dhe thëlluar njohuritë mbi interesin më të lartë të fëmijëve me fokus parandalimin dhe trajtimin e materialeve me përmbajtje të shfrytëzimit dhe abuzimit të fëmijëve.

Hartim dhe zbatim i politikave të bazuara në evidenca



- 🕒 Kryerja e Studimit Kombëtar mbi Përvojat e Fëmijëve Online për të thëlluar njohuritë se si fëmijët përjetojnë internetin, çfarë aktivitete bëjnë dhe cilat janë rreziqet që ata hasin online. Komponenti cilësor i studimit do të ndalet në përvojat online të fëmijëve pa kujdes të menjëhershëm prindëror dhe atyre me aftësi të kufizuara.
- ✦ Kryerja e vlerësimit kombëtar të kuadrit ligjor, politikave dhe kapaciteteve njerëzore për shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve në internet.
- ✦ Asistimi i Qeverisë Shqiptare në finalizimin dhe zbatimin efektiv të "Planit Kombëtar të Veprimit për një internet më të sigurt për fëmijët në Shqipëri".
- ✦ Mbështetja e rishikimit dhe përmirësimit të legjislacionit shqiptar dhe kuadrit të politikave për sigurinë e fëmijëve online.
- ✦ Nxitja e bashkëpunimit të qeverisë dhe industrisë së TIK për të bllokuar dhe hequr materialet e abuzimit të fëmijëve në internet përmes zhvillimit të zgjidhjeve teknike.

Ndërgjegjësim



- 🕒 Mbështetja e të rinjve dhe fëmijëve për tu bërë edukatorë bashkëmohatarë dhe agentë ndryshimi për të informuar dhe promovuar internetin e sigurt në komunitetet e tyre.
- ✦ Rritja e ndërgjegjësimit dhe gatishmërisë për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi në internet përmes fushatave kombëtare të ndërgjegjësimit bazuar mbi gjetjet e studimit kombëtar mbi Përvojat e Fëmijëve Online.
- ✦ Mbështetja e njohurive të fëmijëve dhe prindërve mbi lundrimin e sigurt në internet, përmes zhvillimit dhe promovimit të mjeteve / praktikave.
- ✦ Platformat e raportimit (si ALO 116 dhe ISIGURT.al) do të mbështeten përmes zhvillimit të mjeteve të nevojshme dhe kapaciteteve të stafeve për ti aftësuar ata që të tërheqin, raportojnë dhe menaxhojnë më mirë rastet e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet.





#jamisigurt
online

Partnerët Strategjikë

- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
- Aktorët kryesorë të sektorit privat (Ofruesit e Shërbimeve të Internetit, Kompanitë e Celularëve)
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP
- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike - AKCESK
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit- AKSHI
- Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve; Ministria e Brendshme; Ministria e Drejtësisë dhe Sistemi i Drejtësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Organizatat e Shoqërisë Civile
- Parlamentarët
- Policia e Shtetit
- Media

Për më shumë informacion

UNICEF Shqipëri



Rruga Skenderbej, Ndërtesa e UN, Kati i 3të, Tiranë, Shqipëri



+355 4 4548400



tirana@unicef.org



<https://www.unicef.org/albania>



www.instagram.com/unicefalbania



www.youtube.com/user/unicefalbania



www.facebook.com/unicefalbania

UNICEF Shqipëri shpreh mirënjohjen për mbështetjen financiare të programit "Ti Japim Fund Dhunës Kundër Fëmijëve".

Buxheti total për këtë projekt trevjeçar është 999,915 USD



**End Violence
Against Children**
THE FUND

unicef 
for every child